

ANALIZA STATISTIKORE PËR MUAJIN JANAR Referuar të dhënave zyrtare të ardhura në Autoritetin e Aviacionit Civil shifrat tregojnë një numër prej 222,113 pasagjerë të cilët kanë udhëtuar gjatë muajit Janar...

faqe 6



TË DREJTAT E PASAGJERIT - KOMPENSIME

1200 kompensime në proces nga kompanitë ajrore, përveç 800 pasagjerëve që tashmë janë kompensuar...

faqe 5

MARS 2019 - Botimi XI


posta ajrore



Buletini mujor i Autoritetit të Aviacionit Civil shqiptar

www.aac.gov.al | info@aca.gov.al

Tel: +355 4 22 51 220



EUROCONTROL

PARASHIKIMET PËR 7 VITET QË VIJNË, RRITJE E NUMRIT TË FLUTURIMEVE

faqe 9

VONESA & ANULLIME SHKURT 2019

FLY ERNEST ME NUMRIN ME TË LARTË TË VONESAVE

Muaji Shkurt, pavarësisht se konsiderohet si ndër më të qetët për shkak të uljes të volumit të pasagjerëve regjistroi probleme me vonesat sidomos të disa kompanive ajrore që operojnë fluturime drejt Italisë

faqe 4

AKTIVITETE

BRUKSEL, TAKIM MBI "TARIFAT PËR PERSONAT ME AFTËSI NDRYSHE" (PRM)

faqe 8



DREJTORI I AGJENSISË EUROPIANE TË SIGURISË NË AVIACION, VIZITË 2 DITORE NË TIRANË

PATRICK KY: JU MBËSHITESIM NË VAZHDIMIN E REFORMAVE TUAJA

Patrick Ky, Drejtori i Agjensisë Europiane të Sigurisë në Operim në Aviacion (EASA), ka zhvilluar një vizitë 2 ditore në Tiranë me ftesë të Autoritetit të Aviacionit Civil Shqiptar. Gjatë qëndrimit në Tiranë, zoti Ky zhvilloi një vizitë informuese në ambientet e AAC, ku u diskutua në detaje për reformat e ndërmarra së fundmi në aviacion...

faqe 2-3

TIRANË: DREJTORI I AGJENSISË EUROPIANE TË SIGURISË NË AVIACION, VIZITË 2 DITORE

Patrick Ky, Drejtori i Agjensisë Evropiane të Sigurisë në Operim në Aviacion (EASA), ka zhvilluar një vizitë 2 ditore në Tiranë me ftesë të Autoritetit të Aviacionit Civil Shqiptar. Gjatë qëndrimit në Tiranë, zoti Ky zhvilloi një vizitë informuese në ambientet e AAC, ku u diskutua në detaje për reformat e ndërmarra së fundmi në aviacion. Drejtori i AAC Krislen Keri, e njohu zotin Ky me reformat e ndërmarra në 1 vit, që kanë dhënë edhe rezultate pozitive, çfarë u pasqyrua edhe në raportin e auditit të zhvilluar nga EASA, ku rezultuan vetëm 4 gjetje. Keri, tha se pavarësisht vështirësive, vizioni i tij është për krijimin e një institucioni model, bazuar në praktikat më të suksesshme europiane dhe padyshim duke u mbështetur në modelin e EASAs apo të Eurocontrol. Keri u ndal edhe te aspekti i rëndësishëm i ngritjes së kapaciteve njerëzore, duke shpjeguar nismën e ndërmarrë për trajnime që zhvillohen në Autoritetin e Aviacionit Civil, me pjesëmarrjen e një numri të madh inspektorësh dhe ekspertëve më të mirë botërorë. Këto trajnime janë bërë në bashkëpunim me JAA TO dhe me ICAO, 2 institucione lider në aviacion.



Në foto:
z. Patrick Ky, Drejtori i Agjensisë Evropiane të Sigurisë në Aviacion (EASA) gjatë takimit të zhvilluar pranë zyrave të AAC



Në foto:
Z. Krislen Keri sëbashku me stafin e AAC dhe z. Patrick Ky, Drejtori i Agjensisë Evropiane të Sigurisë në Aviacion (EASA) në takimin e zhvilluar pranë zyrave të AAC.

PATRICK KY: JU MBËSHTESIM NË VAZHDIMIN E REFORMAVE TUAJA

Zoti Ky vlerësoi ecurinë pozitive që ka patur Autoriteti si pasojë e reformave të fundit, që janë bazuar edhe në modelin e suksesshëm organizativ të EASA. Mes të tjerave ai u njoh edhe me hapat e ndërmarra në drejtim të forcimit të aftësive mbikqyrëse në sigurinë në operim dhe sigurinë e aviacionit, por edhe në rritjen e kapaciteteve teknike dhe bashkëpunimit me partnerët Evropian dhe të Organizatave ndërkombëtare të Aviacionit Civil. Gjithashtu zoti Ky, bëri edhe rekomandimet përkatëse për sektorët specifikë që Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të përmirësojë në të ardhmen. Kjo është vizita e parë e që kreu i agjensisë më të rëndësishme të Bashkimit Evropian për aviacionin, zhvillon në vendin tonë dhe në rajon.

Në foto:

Patrick Ky, Drejtori i Agjensisë Evropiane të Sigurisë në Aviacion (EASA) dhe z. Krislen Keri, Drejtori Ekzekutiv i AAC



Në foto:

gjatë takimit të zhvilluar pranë zyrave të AAC




RAPORTI PERFORMANCËS:

KOMPANIA “FLY ERNEST” ME NUMRIN MË TË LARTË TË VONESAVE NË MUAJIN SHKURT

Muaji Shkurt, pavarësisht se konsiderohet si ndër më të qetët për shkak të uljes të volumit të pasagjerëve, regjistroi probleme me vonesat sidomos të disa kompanive ajrore që operojnë fluturime drejt Italisë. Nga të dhënat zyrtare që vijnë nga sektori për të drejtat e pasagjerit, rezulton se numrin më të lartë të vonesave për këtë muaj, vijon ta ketë kompania “Fly Ernest”, që zhvillon disa fluturime ditore me Italinë. Nga të dhënat rezulton se kjo kompani ka regjistruar 7 vonesa për muajin e kaluar, disa prej të cilave mbi 3 orë, dhe deri në mbi 7 orë. Kompanitë e tjera nuk kanë regjistruar probleme, kjo e lidhur edhe me numrin e ulët të pasagjerëve që kërkojnë të udhëtojnë. Kompania e dytë me problematike është “Adria Airways”, e cila ka anuluar një fluturim. Ndërkohë që kompania tjetër që operon me Italinë “Blue Panorama”, ka regjistruar vetëm një vonesë përgjatë muajit të kaluar.

Figura e mëposhtme paraqet numrin e vonesave dhe anulimeve të fluturimeve nga kompanitë ajrore.



TË DREJTAT E PASAGJERIT


1200 KOMPENSIME NË PROCES NGA KOMPANITË AJRORE, PËRVEÇ 800 PASAGJERËVE QË TASHMË JANË KOMPENSUAR. AAC I BËN APËL PASAGJERËVE QË TË KONTAKTOJNË MË KOMPANITË PËR TË PLOTËSUAR DOKUMENTACIONIN

Numri i kompensimeve për muajin Shkurt është rritur me 100 kompensime më shumë krahasuar me muajin Janar. Aktualisht kompanitë ajrore kanë kompensuar me rreth 250 eu ose me bileta, rreth 800 pasagjerë që kanë plotësuar formularët e ankimit për shkak të vonesave apo anulimit të fluturimit të tyre. Pritet që në total numri i kompensimeve të rritet edhe më shumë pasi rreth 1200 formularë të tjerë ankimi janë pranuar nga kompanitë ajrore dhe janë në proces mbylljeje. Autoriteti i Aviacionit Civil shqiptar përsërit apelin ndaj gjithë pasagjerëve që kanë plotësuar formularët dhe i kanë dorëzuar, në mënyrë që të përfitojnë 250 eu kompensim, të komunikojnë me kompanitë që kanë plotësuar formularët sepse është e nevojshme verifikimi ose dërgimi i dokumenteve të nevojshme. Në rastet se ata do të hasin probleme, të kontaktojnë sektorin e të drejtave të pasagjerit të AAC në numrat e telefonit ose e-mailin si më poshtë. Nga të dhënat zyrtare kompania që respekton të drejtën e pasagjerëve për kompensim mbetet Blue Panorama. Ndërsa më problematike mbetet kompania Fly Ernest me vetëm 96 të tilla, ndërkohë që renditet si kompania më problematike me numrin më të lartë të vonesave dhe anulimeve të fluturimeve. Kompania Wizz Air, gjithashtu ka kompensuar një numër të konsiderueshëm pasagjerësh të kompensuar duke shkuar në 74, pavarësisht se renditet ndër kompanitë më serioze në respektimin e orareve.


1200

KËRKESA TË PRANUARA

AAC i bën thirrje gjithë pasagjerëve që kanë plotësuar formularët e ankimit dhe ka kaluar afati prej 6 javësh, që të rikontaktojnë përsëri kompanitë ajrore që kanë patur fluturimin për tu njohur me statusin e fluturimit të tyre. Në rast se kompania nuk i kthen asnjë përgjigje, atëherë të kontaktojnë me sektorin e të Drejtave të Pasagjerit të AAC-së në numrat e telefonit: **+355 42 381 959 / +355 44 539 959** ose me email tek: **pax@acaa.gov.al** dhe do të marrin asistencën e nevojshme. Për më shumë informacion vizitoni gjithashtu dhe linkun e mëposhtëm:



www.aac.gov.al/te-drejtat-e-pasagjerit




ANALIZA STATISTIKORE

■ **JANAR 2019:** Referuar të dhënave zyrtare të ardhura në Autoritetin e Aviacionit Civil shifrat tregojnë një numër prej 222,113 pasagjerë të cilët kanë udhëtuar gjatë muajit Janar për/nga TIA.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet numri i pasagjerëve sipas kompanive ajrore për muajin Janar 2019 dhe zotërimi i tregut të transportit ajror nga secila kompani, në përqindje.

Bazuar në të dhënat zyrtare, kompania ajrore "Blue Panorama" është mbizotëruese në treg duke mbuluar fluksin më të madh të lëvizjes së pasagjerëve për muajin Janar 2019, me një numër prej 56,403 pasagjerë ose 25% të totalit. Ndjekur nga Ernest S.p.a me 18% ndaj totalit dhe 40,523 pasagjerë, duke vijuar me Albawings e cila zotëron tregun me 12% dhe 26,438 pasagjerë, përqindje kjo në rritje krahasimisht me muajt paraardhës. Grafiku i mëposhtëm paraqet fluksin e pasagjerëve që kanë udhëtuar përgjatë muajit Janar 2019, të ndarë sipas kompanive ajrore. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet numri i pasagjerëve sipas kompanive ajrore për muajin Janar 2019 dhe zotërimi i tregut të transportit ajror nga secila kompani, në përqindje.



Grafiku 1:
Zotërimi i tregut nga ana e kompanive ajrore, sipas përqindjes:

■ **PËRQINDJET:** Përqindjen më të madhe në tregun e transportit ajror për muajin Janar 2019 vazhdon ta zotërojë Italia, duke zënë 63% të totalit, ndjekur nga kompanitë Turke, me 9%.

Gjithashtu përgjatë muajit Janar përqindje të tregut ka marrë edhe Hungaria, e cila zotëron 6%, duke kaluar kështu dhe Austrinë e cila përgjatë dhjetorit ka 5% të tregut tonë. Nëse do të bënim krahasimin e tre viteve të fundit, trafiku ajror dhe fluksi i pasagjerëve, ka një rritje prej 4% gjatë Janarit 2019.

ANALIZA STATISTIKORE

NUMRI I PASAGJERËVE Përsa i përket rritjes/rënies së fluksit të lëvizjes së pasagjerëve për muajin Janar 2017-2018-2019, vëmë re se numri i pasagjerëve që kanë fluturuar me kompaninë Wizz Air ka shënuar një rritje prej 177% e krahasuar me Janarin e 2018, pasuar nga Albawings, me një rritje prej 52 %. Gjithashtu duket se ka një ngritje të dukshme edhe kompania Lufthansa me 18%, përqindje kjo e lartë duke marrë parasysh se përgjatë janarit të 2017 ka pasur një humbje prej 22% të fluksit. Kompania Blue Panorama, krahasuar me Janarin e 2018 ka humbur në treg me 16%, rënie për këtë kompani me 10% duket se ka pasur edhe Janari i vitit 2018 krahasimisht me Janarin e 2017.

Grafiku i mëposhtëm paraqet krahasimin e numrit të pasagjerëve në muajin Janar 2019 kundrejt së njëjtës periudhë të vitit 2018 dhe 2017:




Tabela 1:
Numri i pasagjerëve për Janar 2017, 2018, 2019
sipas kompanive ajrore.

CARGO Transporti i ngarkesës Cargo gjatë muajit Janar 2019 ka rritje prej 8% kundrejt vitit 2018, ndërsa përgjatë Janarit të vitit 2018 ka pasur rritje prej 12% krahasuar me 2017. Shifrat më të larta në transportin Cargo i përkasin kompanisë "Turkish Airlines" duke vijuar me kompaninë "Austrian Airlines".

AKTIVITETE TË DREJTORIVE TË AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL GJATË MUJIT SHKURT

WORKSHOP NË BRUKSEL MBI "TARIFAT PËR PERSONAT ME AFTËSI NDRYSHME"

Në datën 18/02/2019 u zhvillua në Bruksel workshopi me temë "Tarifat për personat me aftësi ndryshe" (Persons with reduced mobility charges). Workshopi u zhvillua në ambientet e ACI, me pjesëmarrje të shteteve të ndryshme si Anglia, Italia, Portugalia, përfaqësues të komisionit European dhe palëve të interesit, si kompanive ajrore dhe aeroporteve. Çështjet që u trajtuan në workshop ishin të ndara në katër seksione:

- Kuadri rregullativ dhe llojet e ndryshme të paaftësive.
- Kriteret për vendosjen e tarifave dhe procedurat.
- Standardet e cilësisë për asistencën.
- Roli i Autoriteteve Kombëtare.

Baza ligjore përfshin Rregulloren Europiane 1107/2006, Dokumentin 30 të ECA, i cili përfshin



standardet ndërkombëtare dhe praktikat e rekomanduara, Aneksin e ri V si dhe rregulloret dhe politikat kombëtare. Duke qenë një çështje mjaft të ndjeshme dhe e lënë pak në harresë Komisioni European ka rishikuar rregulloren, përfshirë materialet udhëzuese dhe priten reagime (feedback) deri në Mars të këtij viti, pasi në verën e këtij viti është parashikuar rifreskimi dhe publikimi i tyre. Përfaqësuesit e shteteve konstatuan të njëjtat probleme në lidhje me këtë çështje si:

- Mungesa e të dhënave
- Mungesa e transparencës, ku dhe si lekët përdoren?
- Benefitet e investimit afatgjatë të PRM charges kundrejt kostove afatshkurtra.

Përfaqësues të veçantë theksuan faktin se në kuadrin rregullativ duhet përcaktuar qartë definicioni për PRM dhe çfarë asistence kërkohet, duke zvogëluar mundësinë për keqinterpretime.

Përfaqësuesja e Forumit European për PRM, bazuar në Art. 9 të U.N. parashtroi facilitetet që duhen krijuar për këtë kategori, pasi nevoja të ndryshme kërkojnë standarte të ndryshme. Kriteret dhe procedurat për vendosjen e tarifave PRM kalojnë mes një procesi

të gjatë dhe gjithëpërfshirës konsultimesh mes palëve të interesit, por rregullorja thekson se është niveli menaxherial i aeroportit ai që vendos nivelin e tarifave dhe palët e tjera nuk mund të imponojnë aeroportin.

Ngelet si një sfidë gjetja e një balance midis:


- Rritjes së asistencës dhe një shërbimi shumë të mirë
- Mbulimi i plotë i kostove nga transportuesi që i shikon tarifat PRM si një kosto të aeroportit që duhet zvogëluar.

Standardet e cilësisë janë në varësi të:

- Harmonizimit mes aeroporteve
- Përmirësimit të nivelit të shërbimit
- Aftësive profesionale
- Mbi përdorimin të shërbimeve
- Numrit të asistentëve

Autoritetet kombëtare rregullatore, veçanërisht departamenti i të drejtave të pasagjerëve duhet të harmonizojnë dhe implementojnë kuadrin rregullator. Realizimi i auditeve vjetore duke kontrolluar në mënyrë periodike nivelin e tyre, transparencën dhe trajnimet e stafit është përgjegjësi e tyre.

- Workshopi nxorri si konkluzione kryesore:
- Krijimi i një linku/lidhje midis cilësisë së shërbimit dhe nivelit të tarifimit.
- Përcaktimi qartë i definicionit mbi PRM
- Matja e nivelit të kënaqësisë nga pasagjerët mes pyetësorëve dhe anketimeve të ndryshme.
- Identifikimi i çështjeve të sigurisë për personat shoqërues.



Aviacioni në Botë



EUROCONTROL: PARASHIKIMET PËR 7 VITET QË VIJNË, RRIJTJE E NUMRIT TË FLUTURIMEVE

Agjensia Europiane për Sigurinë në Operimin Ajror, ka publikuar një raport me parashikime për rritjen e numrit të pasagjerëve për 7 vitet që vijnë, ku pritjet që në 2025 të ketë 12.67 milion fluturime. Parashikimi ka marrë parasysh edhe problemet ekonomike që janë në disa shtete të Europës, apo edhe daljen e Britanisë së Madhe prej saj. Duke u ndalur fillimisht të 2018, që u konsiderua si viti me rritjen më të lartë të trafikut ajror krahasuar me 2017. Në total shifra e fluturimeve ishte 11.00 milion, megjithatë parashikimet janë se do të ketë një rritje edhe më të madhe në vitet që vijnë. Në 2019, rritja është parashikuar të shkojë në 11.31 milion fluturime, më e ulët po të krahasohet me 2018, për shkak të paqartësive që vijnë nga situata ekonomike dhe politike në disa shtete europiane, sidomos Brexit. Në vitin 2020 parashikohet një rritje me 3% për të kapur ndoshta 11.65 milion fluturime, pak a shumë rritje e njëjtë me vitin 2019. Vitet që është parashikuar

edhe një rritje e madhe janë 2021-2025, që mund të shkojë në 1.8% nga viti në vit, për të kapur pikun me 12.67 milion fluturime. Shqetësimi më i madh është i lidhur me atë që mund të sjellë Brexit, çfarë mund ta ulë ose rrisë përqindjen. Raporti ngre edhe shqetësimin për rritjen e kapaciteteve nga operatorët si kompanitë ajrore por edhe nga kompanitë që menaxhojnë shërbime në aeroporte. Pasi një pjesë e madhe e problematikave të evidentuara në vitin 2018, që shënuan edhe numrin më të lartë të vonesave në gjithë historinë e aviacionit civil, erdhi si pasojë e mungesës së kapaciteteve apo fluksit të lartë në disa korridore ajrore që përdoren nga kompanitë ajrore. Eurocontrol po punon dhe shumë shpejt do të dalë me propozime konkrete për të krijimin e disa korridoreve të reja ajrore, por që duhet të ndiqet nga rritja e kapaciteteve nga operatorët e ndryshëm.

Grafiku 2:
Parashikimet për vitin 2019,
sipas shteteve të EU

